

PYETJE TË SHPESHTA

**Urdhëresa mbi udhëtimet hyrëse në lidhje me koronavirusin – e vlefshme si fillim që nga 11 Gushti**

## **Për cilët individë të cilët hyjnë në vend vlen detyrimi për të qëndruar në karantinë në shtëpi?**

Qeveria federale dhe republikat kanë rënë dakord që njerëzit të cilët hyjnë në vend nga zonat me rrezik duhet të qëndrojnë kryesisht 14 ditë në karantinë në shtëpi.

## **Cilat shtete konsiderohen me rrezik?**

Zonat me rrezik caktohen nga qeveria federale dhe publikohen nga Instituti Robert Koch (RKI). Këtu përfshihen edhe numri i rasteve edhe një vlerësim i incidencës përkatëse të testimit dhe të infeksionit. Ju mund ta gjeni një pasqyrë të zonave aktuale me rrezik [këtu](#).

## **Cilat përjashtime nga rregulli i karantinës vlejné duke filluar nga 15 Korrik 2020?**

Detyrimi i karantinës për individët e rikthyer nga zona me rrezik nuk vlen nëse paraqitet një test negativ koronavirusi i cili është kryer më pak se 48 orë para hyrjes. Koha për përcaktimin e rezultatit të testimit është vendimtare për afatin e fundit. Testi mund të përsëritet gjithashtu në Gjermani; gjithsesi, rregullat e karantinës duhet të zbatohen si fillim derisa të merret rezultati negativ.

Për më tepër, ekzistojnë përjashtime, p.sh për individët të cilët për arsye profesionale transportojnë përmes kufinjve individë, mallra ose produkte nëpërmjet transportit rrugor, hekurudhor, detar ose ajror si dhe për individë të cilët hyjnë në Gjermani për më pak se 72 orë për arsye specifike (vizitë nga familjarë, kujdestari, vizitë nga partnerët e jetës, etj.) . Përveç kësaj, nuk vlen më detyrimi për karantinë për personat të cilët ndodhen në tranzit përmes Nordrhein-Westfalen (pa qëndruar tërë natën).